1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6	7
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Njësia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (4 x 5)	Afati
1.	<i>Software</i>	Shërbim	1			
2.	<i>Shërbim mirëmbajtje</i>	Shërbim	1			
Fondi limit					1,460,833	
		Çmimi total (Shërbimet)				Lekë PA TVSH
	Çmimi Neto pa TVSH					
	TVSH (%)					
	Çmimi total me TVSH:					
	Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
	Nënshkrimi					
	Vula					
	Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR “SOFTWARE MENAXHIMI BURIMESH NJERËZORE”

Për administrimin e burimeve njerëzore objektivat kryesore të zbatimit të sistemit janë:

- Krijimi i strukturës administrative, duke specifikuar çdo njësi organizative.
- Krijimi i kartelës së punonjësit me të dhënat e tij.
- Menaxhimi i trajnimeve.
- Përgatitja e listpagesës dhe gjenerimi i fletëpagesave (payslipeve)
- Evidentimin e pozicioneve vakante.
- Menaxhimi i performances së punonjësve.
- Historikun e masave disiplinore, trainimeve, ndryshimeve të pozicionit, ndryshimin e pagave etj.

Pamje e përgjithshme e sistemit

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore mbështet identitet sh.a. në mbajtjen e evidencave mbi listën e punonjësve të shoqërisë, mbi pagat, kostot e lidhura me punonjësit. Ky sistem gjithashtu mundëson regjistrimin e listëprezencës mujore dhe mbajtjen e aktiviteteve të ndryshme që lidhen me punonjësit, si trajnimet, rekrutimet etj.

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore përfshin funksionet e mëposhtme:

- Krijimi i strukturës administrative, duke specifikuar çdo njësi organizative.** Në sistem mund të krijohen departamentet dhe nën-departamentet ose sektorët e institucionit. Në bazë të tyre, mund të përcaktohen dhe pozicionet e punës së punonjësve. Gjithashtu sistemi duhet të gjenerojë raporte të ndryshme sipas departamenteve apo ndarjeve të tjera.
- Krijimi i dosjes personale të punonjësit me të dhënat e tij.** Kartela e punonjësit ruan të dhënat e plota që përfshijnë: nr personal, emër, mbiemër, datëlindjen, departamentin, detyrën që kryen, të dhëna për punësimin si datë fillimi, nr kontratës, paga bazë mujore. Te gjithë informacionet në kartelën e punonjësit shfaqin informacion historik, pra duke shfaqur në rend kronologjik të gjithë ndryshimet që kanë ndodhur.
- Menaxhimi i trajnimeve.** Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e trajnimeve që kryhen me punonjësit. Ky sistem është një mjet i rëndësishëm për dhënien e informacioneve për trajnimet që realizohen në shoqëri, duke përfshirë trajnimet e përfunduara. Informacionet që shënohen për trajnimet përfshijnë: titullin e trajnimit, vendin e realizimit, datën e zhvillimit, trajnuesin ose trajnuesit, pjesëmarrësit. Gjithashtu sistemi gjeneron raporte të ndryshme mbi trajnimet e zhvilluara.
- Menaxhimi i vlerësimeve të performancës.** Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e vlerësimeve të performancës së punonjësve. Informacionet që shënohen për vlerësimin e punonjësve përfshijnë: pikët e marra, vlerësimin, periudhën e vlerësimit. Gjithashtu sistemi duhet të gjenerojë raporte të ndryshme mbi vlerësimet sipas punonjësve ose departamenteve.
- Sistemi duhet të mundësojë ngarkimin në sistem të dokumentave të ndryshme si psh:** kontrata e punës, vendimet për rritje në detyrë ose rritje page, raportet mjekësore të punonjësve, paralajmërimet ose vendimet për largim nga puna etj.

-
- f) **Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin e vërtetimeve të ndryshme si psh:** Vërtetime pune, vërtetime page për çdo punonjës të selektuar nga përdoruesi i sistemit. Vërtetimet mund të kërkojnë për punonjës aktual ose për punonjës të larguar nga puna.
- g) **Sistemi të bëjë të mundur opsionin për leje si psh:** me anë të një link-u (ndërfaqe) dhe aprovim nga hierarkia përkatëse, gjithashtu menaxheri/supervizori të njoftohet me e-mail kur krijohet një kërkesë e re.
- h) **Sistemi duhet të përgatisë listëpagesën dhe fletëpagesat:** Në bazë të listëprezencës sistemi duhet të përllogarisë pagat e secilit punonjës dhe të gjenerojë listëpagesën finale dhe fletëpagesat për çdo punonjës. Të mundësoi ngarkimin në sistem në format excel të listëprezencës finale për departament nga përdoruesi i sistemit dhe në bazë të listëprezencës së ngarkuar të përllogarisë pagat dhe listëpagesën finale (përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, tatimin e të ardhurave nga punësimi si dhe shtesa ose mbajtje të tjera)

Sistemi duhet të përmbajë formula të cilat mund të përdoren për të llogaritur apo transformuar të dhëna komplekse të cilat mund të vijnë nga shumë burime. Formulatat do të shërbejnë për të llogaritur psh në listëpagesë zëra të pagesave dhe ndalesave të punonjësve.

Sistemi duhet të mundësojë llogaritjen e pagave edhe në rast se paga bruto e punonjësit ka ndryshuar gjatë muajit.

Të dhënat që mund të shërbejnë si burim për llogaritjen e pagave por pa u kufizuar vetëm në to janë:

1. Orët e punës së punonjësve për periudhën përkatëse të detajuara sipas llojit:
 - orë të zakonshme
 - orë jashtë orarit
 - ditë feste
 - orë të punuara në ditë feste
 - orë të punuara turn i dytë/tretë
 - raport mjeksor për periudhën deri në 14 ditë të pagueshme nga shoqëria
 - leje të zakonshme
 - leje të paguara sipas rasteve që parashikon kodi i punës
2. Të dhëna të tjera që mund të specifikohen nga identiteti sh.a në të ardhmen.
3. Pagesat/ndalesat e punonjësve të detajuara sipas llojit:
 - Shpërblime të zakonshme mbi të cilat llogariten sigurimet shoqërore
 - Shpërblime mbi të cilat nuk llogariten sigurimet shoqërore
 - Paradhënie
 - Ndalesa për dem ekonomik, etj.

Sistemi duhet te jete i përshtatshëm për të mundësuar lehtësisht konfigurime sipas preferencave të identitë sh.a, për të shtuar të dhëna burim të reja ose funksionalitete të reja në mënyrë që sistemi i burimeve njerëzore ti përshtatet sa më mirë nevojave të identitë sh.a.

Sistemi duhet të plotësojë këto kushte teknike:

- Të punojë në një rrjet kompjuterik të gjerë (LAN, WAN, WEB);
- Të aksesohet nëpërmjet një shfletuesi (browser) dhe të lejojë që përdoruesit të punojnë njëkohësisht për regjistrime të ndryshme;
- Të sigurojë një lidhje të sigurt dhe të kriptuar me TSL/SSL nëpërmjet protokollit HTTPS midis shfletuesit (browser-it) dhe serverit;
- Të kontrollojë për karaktere gabim në çdo html apo sql query;
- Të sigurojë një seri mesazhesh që sinjalizojnë dhe orientojnë përdoruesin gjatë regjistrimit të të dhënave çka minimizon gabimet njerëzore;
- Ndërfaqet e programit të jenë të gjitha në gjuhën Shqipe me ndërfaqe përdoruesi miqësore;
- Te ofroje modul te veçantë për administrimin e të drejtave të përdoruesve;
- Fjalëkalimet të ruhen në bazën e të dhënave të kriptuara çka bën të pamundur gjetjen e fjalëkalimeve të përdoruesve.
- Administratori i sistemit të ketë mundësi:
 - Ti japi të drejta të ndryshme përdoruesëve të ndryshëm si psh: modifikim dhe shikueshmëri
 - Të rivendosë fjalëkalimin e një përdoruesi;
 - Të vendosë disa procedura për fjalëkalimet;
 - Të ruaj historikun e fjalëkalimeve;
 - Të caktojë procedurat e skadimit të fjalëkalimeve pas një periudhe të caktuar;
 - Të bllokojë një përdorues kur tenton disa herë duke futur fjalëkalim të gabuar.
- Të gjitha hyrjet e përdoruesve në program të regjistrohen për efekte auditimi.
- Të gjitha krijimet, fshirjet e dokumenteve nga ana e përdoruesve të regjistrohen në program.
- Të regjistroje kohen, datën, orën e gjithë veprimeve të përdoruesve.

Platforma	Microsoft Windows SERVER 2022 standart, Linux
Baza e të dhënave	MS SQL, Oracle ose open source SQL
IDEs	Any text editor
Browsers	Google Chrome , Microsoft Internet Explorer, Mozilla Firefox ose te ngjashem
Raporte	Raporte Pivot Raporte Html

Kërkesat për Licencë dhe Mbështetje Teknike

1. Mbështetja teknike dhe trajnimi

- Të ofrohet mbështetje teknike e plotë për përdoruesit e sistemit.

-
- Të sigurohen manuale përdorimi, si dhe dokumentacion i plotë për instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.
 - Të ofrohet trajnim i dedikuar për stafin që do të përdorë programin.

2. Licencimi

- Programi duhet të jetë i pajisur me licencë të përhershme, pa afat përdorimi.
- Nëse programi kërkon instalim në Windows Server 2022 Standard dhe nevojitet licencë shtesë, licenca duhet të sigurohet nga kompania ofertuese.

3. Reagimi në raste emergjente

- Në rast emergjence, kompania ofertuese duhet të sigurojë mbështetje teknike në institucion brenda 1 (një) dite pune.

4. Kushtet e mbështetjes teknike

- Mbështetja teknike duhet të ofrohet për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- Të sigurohet asistencë dhe mbështetje gjatë orarit zyrtar, përfshirë mundësinë për kontakt të drejtpërdrejtë me ekipin e supportit.

Kërkesa teknike shtesë

- Kompania ofertuese duhet të garantojë se sistemi përmban procedura për “back-up” automatik dhe periodik në serverin e rrjetit.
- Të ofrohet dokumentacion teknik dhe udhëzime të detajuara për përdoruesit.
- Për çdo kategori raportesh, programi duhet të mundësojë përdorimin e filtrave për përzgjedhjen e sasisë dhe llojit të informacionit që përdoruesi dëshiron të shfaqë.

Fleksibiliteti

Sistemi duhet të jetë shumë fleksibel. Nëse kërkesat e ardhshme të Identitek sha. do të ndryshojnë sistemi duhet të akomodojë ndryshimet pa pasur efekte të rëndësishme të funksioneve ekzistuese.

Siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave

Identitek sha kërkon që kompania ofertuese të garantojë konfidencialitetin e të dhënave sensitive. Sistemi duhet të jetë i sigurt dhe të garantojë që informacioni në sistem të jetë i vlefshëm, sipas hierarkisë së përdoruesit. Pra përdoruesit duhet të kenë akses vetëm në të dhënat që do tu jepen të drejta, sipas rolit që do ti percaktohet në sistem.

Sistemi kompjuterik i propozuar duhet të ruaje të gjitha veprimet e ruajtjes të bëra në të, me qëllim auditimin e sistemit. Për më tepër, me qëllim analizimin e këtyre të dhënave, sistemi duhet të jetë i pajisur me raporte përkatëse të organizuar për çdo përdorues, modul, etj.

Për çdo rast, të dhënat gjurmuese duhet të jenë të vlefshme për çdo veprim ruajtje që kryhet në sistem, për çdo përdorues.

Aneks 7.2 – Kërkesat funksionale dhe teknike për sistemin

Ref.	Sistemi	Kërkesa	
	Kërkesa te Përgjithshme		
		Sistemi duhet të jetë i ndërtuar në mënyrë modulare, çdo modul duhet të jetë plotësisht i integruar me pjesët e tjera të sistemit për të operuar si një sistem i vetëm	
		Duhet të krijohen shërbimet respektive të implementimit të sistemit të monitorimit dhe auditimit Imperva per bazën e të dhënave të sistemit	
		Sistemi duhet të jetë web application dhe të aksesohet nëpërmjet ndërfaqeve Web nëpërmjet të gjithë shfletuesve web (web browser)	
		Të lejojë që përdoruesit të mund të punojnë njëkohësisht për procese e regjistrime të ndryshme	
		Duhet të funksionojë në rrjet kompjuterik të gjerë (LAN, WAN, WEB)	
		Sistemi duhet të jetë kompatibël për tu instaluar në server me sistem operimi Linux ose Windows server 2022	
	Gjuha e Sistemit		
		Ndërfaqet e programit duhet të jenë tërësisht në gjuhën Shqipe me ndërfaqe përdoruesi miqësore	
	Raportet		
		Sistemi duhet të ofrojë mundësi për të krijuar raporte përmbledhëse me informacion për të gjitha njësitë vartëse	
		Raportimi duhet të jetë i shumëllojshëm dhe të ofrohen informacione për çdo funksion apo për çdo njësi pune, në mënyrë të përmbledhur dhe analitike	
		Raportet duhet të gjenerohen shpejt dhe të eksportohen në formate të ndryshme (PDF, Excel)	

		Për çdo kategori raportesh programi duhet të mundësojë filtra nëpërmjet të cilave përdoruesi përzgjedh sasinë dhe llojin e informacionit që kërkon të shohë	
		Programi duhet të mundësojë filtra të personalizuar; kombinime të filtrave të cilat përdoren më shpesh nga përdoruesi duhet të ruhen si filtra të personalizuar	
	Lista e Raporteve te gatshme		
		Regjistri themeltar	
		Skeda individuale e punonjësit	
		Raport mbi listën e personelit sipas datave të kërkuara	
		Raporte për arsimin e punonjësve	
		Raport mbi emërimet në detyrë	
		Raport për të larguarit nga puna dhe arsye largimi	
		Raport për vendet vakante bazuar në strukturën e aprovuar	
		Raport për masat disiplinore	
		Skeduli dhe historiku i lejeve të zakonshme	
		Raporte për moshën e punonjësve (sipas grupmoshave)	
		Raporte kujtesë për njoftim për mbarimin e kontratave të punes (në rastin e kontratave me afat)	
		Raport mbi ndryshime të pozicionit të personelit	
		Raport për numrin e Meshkuj / Femra	
		Sistemi duhet të japë mundësinë e krijimit të raporteve Pivot sipas preferencave të përdoruesit mbi të gjithë fushat e ekspozuara nga baza e të dhënave	
		Raport në lidhje me listëpagesën dhe fletëpagesave për çdo punonjës, mbajtjet dhe shtesat e përfituara.	
	Siguria		
		I gjithë konfigurimi dhe politikat e sigurisë duhet të ruhen në serverin qendror	
		Në lidhje me aksesin lokal tek baza e të dhënave (si psh: IPC, Shared Memory, etj) zgjidhja e ofruar duhet t'i	

		raportojë të dhëna të detajuara në lidhje me koneksionin (user i përdorur për tu lidhur me DB dhe OS user nga ku është kryer lidhja)	
		Kanali i lidhjes midis shfletuesit (browser-it) dhe serverit qëndror duhet të jetë e sigurt dhe i kriptuar me TSL/SSL nëpërmjet protokollit HTTPS	
		Programi duhet të bëjë verifikim të të dhënave (validation) si në anën klient (client-side validation) ashtu dhe në anën e serverit (server-side validation)	
		Të mund të kontrollojë për karaktere jo të pritura ose të ndaluara si html apo sql query	
		Duhet të ofrojë kontroll të menjëhershëm të të dhënave për përdoruesit e autorizuar	
		Fjalëkalimet të ruhen në bazën e të dhënave me një kriptim të njëanshem për të patur të pamundur gjetjen e fjalëkalimeve të përdoruesve	
		Administratori të ketë mundësi të rivendosë fjalekalimin e një përdoruesi dhe të japi të drejta të ndryshme përdoruesit	
		Të mund të ofrojë aplikimin e politikave të fjalëkalimit të ndryshme	
		Të mund të ofrojë mundësinë e ruajtjes së historikut të fjalëkalimeve	
		Të mund të ofrojë mundësinë për të vendosur një numër të caktuar historiku fjalekalimesh për tu ruajtur	
		Të mundësojë mos lejimin e krijimit të fjalëkalimeve jo komplekse, pra fjalëkalimi të përmbajë të paktën dy nga elementet e mëposhtme: një gërmë të madhe, numër ose karakter special	
		Të mundësojë detyrimin ndaj përdoruesit për të ndërruar fjalëkalimin pas hyrjes së ardhshme në sistem	
		Të mundësojë skadimin e fjalëkalimit pas një numri të caktuar ditësh	
		Të mundësojë caktimin e ditëve për skadimin e fjalëkalimit.	
		Të mundësojë përcaktimin e gjatësisë minimale për një fjalëkalim	

		Të mundësojë bllokimin e një përdoruesi kur ai tenton disa herë duke futur një fjalëkalim të gabuar	
		Të mundësojë përcaktimin e numrit të tentativave të lejuara për një përdorues që gabon fjalëkalimin	
		Të mundësoi që përdoruesit të shikojnë ose modifikojnë fusha të caktuara në program	
		Të mundësojë regjistrimin e cdo krijimi, fshirje apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve	
		Të mundësojë regjistrimin e datës, orës për përdoruesit që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit	
		Të mundësojë historikun e veprimeve pra të mund të shikohen dokumentat si kanë qenë para modifikimit	
		Të ofrojë mundësinë për të përcaktuar privilegje të detajuara deri në çdo klik që mund të bëhet në sistem. Administratori i sistemit të ketë mundësi të jap autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, shtojë, ndryshojë, fshijë të dhëna të caktuara apo edhe të ketë apo jo të drejtën për të bërë një kërkesë në server nga një buton apo funksionalitet tjetër i ndërfaqes	
		Kompania ofertuese të garantojë që sistemi përmban procedura për “backup” automatik dhe periodik në server	
Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore			
		Sistemi duhet të ruajë punonjësit dhe të dhënat e tyre të përgjithshme	
		Sistemi duhet të ruajë kualifikimet e punonjësve	
		Sistemi duhet të ruajë eksperiencën e punonjesit	
		Sistemi duhet të ruajë vlerësimet e performancës së punonjësit	
		Sistemi duhet të ruajë pagën dhe historikun e saj	
		Sistemi duhet të ruajë lejet e dhëna për punonjësit	
		Sistemi duhet të ruajë datat e raporteve mjekësore të punonjësve	

		Sistemi duhet të ruajë departamentet ku ka punuar dhe detyrat që ka patur gjatë kohës që ka punuar në shoqëri	
		Sistemi duhet të ketë mundësinë e organizimit të punonjësve sipas departamenteve dhe nën departamenteve.	
		Në çdo moment duhet të gjenerohet skema organizative e shoqërisë	
		Sistemi duhet të ofrojë ruajtjen e hierarkisë së divizioneve, departamenteve dhe krijimin automatik të organigramës	
		Sistemi duhet të ketë ruajtjen e ndërvarësisë së pozicioneve dhe shfaqjen automatike të skemës së ndërvarësisë për secilin pozicion	
		Sistemi duhet të ruajë historikun e kategorisë së punësimit që përdoret për deklarime tatimore nga Departamenti Financës (listëpagesa)	
		Sistemi duhet të mundësojë ngarkimin në sistem të dokumentave të ndryshme si psh: kontrata e punës, vendimet për rritje në detyrë ose rritje page, raportet mjekësore të punonjësve, paralajmërimet ose vendimet për largim nga puna etj.	
		Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e opsion për lejet e zakonshme me anë të 1 (një) link-u (ndërfaqe) për të gjithë punonjësit e shoqërisë pa qënë përdorues i sistemit dhe kërkesa e secilit të shkojë për aprovim nga hierarkia përkatëse	
		Sistemi duhet të mundësojë ngarkimin e të dhënave për pagat mujore të çdo departamenti manualisht me tabela Excel-i: ditët e punuara, orët shtesë, ditët me raport mjekësor etj	
		Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin e vërtetimeve të ndryshme si psh: Vërtetime pune, vërtetime page për çdo punonjës të selektuar nga përdoruesi i sistemit. Vërtetimet mund të kërkojnë për punonjës aktual ose për punonjës të larguar nga puna.	
		Në bazë të listëprezencës sistemi duhet të përlllogarisë pagat e secilit punonjës dhe të gjenerojë listëpagesën finale dhe fletëpagesat për çdo punonjës. Të mundësoi ngarkimin në sistem në format excel të listëprezencës finale për departament nga përdoruesi i sistemit dhe në bazë të listëprezencës së ngarkuar të përlllogarisë pagat dhe listëpagesën finale (përfshire sigurimet shoqërore dhe	

		shëndetsore, tatimin e të ardhurave nga punësimi si dhe shtesa ose mbajtje të tjera)	
		Sistemi të bëj të mundur opsionin për leje si psh: me anë të link-u (ndërfaqe) dhe aprovim nga hierarkia përkatëse gjithashtu menaxheri/supervizori të njoftohet me e-mail krijohet një kërkesë e re.	

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “*Blerje Software për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore*”.

Periudha e implementimit të software do të jetë 3 (tre) muaj duke nisur nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Kohëzgjatja 12 (dymbëdhjete) muaj nga marrja në dorëzim, duke ju referuar periudhës së mirëmbajtjes.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: ***“Blerje Software për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore***

Konsulenca do të konistoj në pikat më poshtë:

Kërkesat që duhen plotësuar për shërbimin, Blerje Software për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë:

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore përfshin funksionet e mëposhtme:

- a) **Krijimi i strukturës administrative, duke specifikuar cdo njesi organizative.** Në sistem mund të krijohen departamentet dhe nën-departamentet ose sektorët e institucionit. Në bazë të tyre, mund të përcaktohen dhe pozicionet e punës së punonjësve. Gjithashtu sistemi duhet të gjenerojë raporte të ndryshme sipas departamenteve apo ndarjeve të tjera.
- b) **Krijimi i dosjes personale të punonjësit me të dhënat e tij.** Kartela e punonjësit ruan të dhënat e plota që përfshijnë: nr personal, emër, mbiemër, datëlindjen, departamentin, detyrën që kryen, të dhëna për punësimin si datë fillimi, nr kontratës, paga bazë mujore. Te gjithë informacionet në kartelen e punonjësit shfaqin informacion historik, pra duke shfaqur në rend kronologjik të gjithë ndryshimet që kanë ndodhur.
- c) **Menaxhimi i trajnimeve.** Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e trajnimeve që kryhen me punonjësit. Ky sistem është një mjet i rëndësishëm për dhënien e informacioneve për trajnimet që realizohen në shoqëri, duke përfshirë trajnimet e përfunduara. Informacionet që shënohen për trajnimet përfshijnë: titullin e trajnimit, vendin e realizimit, datën e zhvillimit, trajnuesin ose trajnuesit, pjesëmarrësit. Gjithashtu sistemi gjeneron raporte të ndryshme mbi trajnimet e zhvilluara.
- d) **Menaxhimi i vlerësimeve të performancës.** Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e vlerësimeve të performancës së punonjësve. Informacionet që shënohen për vlerësimin e punonjësve përfshijnë: pikët e marra, vlerësimin, periudhën e vlerësimit. Gjithashtu sistemi duhet të gjenerojë raporte të ndryshme mbi vlerësimet sipas punonjësve ose departamenteve.
- e) **Sistemi duhet të mundësojë ngarkimin në sistem të dokumentave të ndryshme si psh:** kontrata e punës, vendimet për rritje në detyrë ose rritje page, raportet mjekësore të punonjësve, paralajmërimet ose vendimet për largim nga puna etj.
- f) **Sistemi duhet të mundësojë gjenerimin e vërtetimeve të ndryshme si psh:** Vërtetime pune, vërtetime page për çdo punonjës të selektuar nga përdoruesi i sistemit. Vërtetimet mund të kërkojnë për punonjës aktual ose për punonjës të larguar nga puna.
- g) **Sistemi të bëjë të mundur opsionin për leje si psh:** me anë të një link-u (ndërfaqe) dhe aprovim nga hierarkia përkatëse, gjithashtu menaxheri/supervizori të njoftohet me e-mail kur krijohet një kërkesë e re.
- h) **Sistemi duhet të përgatisë listëpagesën dhe fletëpagesat:** Në bazë të listëprezencës sistemi duhet të përllogarisë pagat e secilit punonjës dhe të gjenerojë listëpagesën finale dhe fletëpagesat për çdo punonjës. Të mundësoi ngarkimin në sistem në format excel të listëprezencës finale për departament nga përdoruesi i sistemit dhe në bazë të listëprezencës së ngarkuar të përllogarisë pagat dhe listëpagesën finale (përfshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, tatimin e të ardhurave nga punësimi si dhe shtesa ose mbajtje të tjera)

Sistemi duhet të përmbajë formula të cilat mund të përdoren për të llogaritur apo transformuar të dhëna komplekse të cilat mund të vijnë nga shumë burime. Formulatat do të shërbejnë për të llogaritur psh në listëpagesë zëra të pagesave dhe ndalesave të punonjësve.

Sistemi duhet të mundësojë llogaritjen e pagave edhe në rast se paga bruto e punonjësit ka ndryshuar gjatë muajit.

Të dhënat që mund të shërbejnë si burim për llogaritjen e pagave por pa u kufizuar vetëm në to janë:

1. Orët e punës së punonjësve për periudhën përkatëse të detajuara sipas llojit:
 - orë të zakonshme
 - orë jashtë orarit
 - ditë feste
 - orë të punuara në ditë feste
 - orë të punuara turn i dytë/tretë
 - raport mjeksor për periudhën deri në 14 ditë të pagueshme nga shoqëria
 - leje të zakonshme
 - leje të paguara sipas rasteve që parashikon kodi i punës
2. Të dhëna të tjera që mund të specifikohen nga identiteti sh.a në të ardhmen.
3. Pagesat/ndalesat e punonjësve të detajuara sipas llojit:
 - Shpërblime të zakonshme mbi të cilat llogariten sigurimet shoqërore
 - Shpërblime mbi të cilat nuk llogariten sigurimet shoqërore
 - Paradhënie
 - Ndalesa për dem ekonomik, etj.

Sistemi duhet të jetë i përshtatshëm për të mundësuar lehtësisht konfigurime sipas preferencave të identitetit sh.a, për të shtuar të dhëna burim të reja ose funksionalitete të reja në mënyrë që sistemi i burimeve njerëzore të përshtatet sa më mirë nevojave të identitetit sh.a.

1. Mbështetja teknike dhe trajnimi

- Të ofrohet mbështetje teknike e plotë për përdoruesit e sistemit.
- Të sigurohen manuale përdorimi, si dhe dokumentacion i plotë për instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit.
- Të ofrohet trajnim i dedikuar për stafin që do të përdorë programin.

2. Licencimi

-
- Programi duhet të jetë i pajisur me licencë të përhershme, pa afat përdorimi.
 - Nëse programi kërkon instalim në Windows Server 2022 Standard dhe nevojitet licencë shtesë, licenca duhet të sigurohet nga kompania ofertuese.

3. Reagimi në raste emergjente

- Në rast emergjence, kompania ofertuese duhet të sigurojë mbështetje teknike në institucion brenda 1 (një) dite pune.

4. Kushtet e mbështetjes teknike

- Mbështetja teknike duhet të ofrohet për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- Të sigurohet asistencë dhe mbështetje gjatë orarit zyrtar, përfshirë mundësinë për kontakt të drejtpërdrejtë me ekipin e supportit.

Kërkesa teknike shtesë

- Kompania ofertuese duhet të garantojë se sistemi përmban procedura për “back-up” automatik dhe periodik në serverin e rrjetit.
- Të ofrohet dokumentacion teknik dhe udhëzime të detajuara për përdoruesit.
- Për çdo kategori raportesh, programi duhet të mundësojë përdorimin e filtrave për përzgjedhjen e sasisë dhe llojit të informacionit që përdoruesi dëshiron të shfaqë.

Fleksibiliteti

Sistemi duhet të jetë shumë fleksibel. Nëse kërkesat e ardhshme të Identitek sh.a., do të ndryshojnë sistemi duhet të akomodojë ndryshimet pa pasur efekte të rëndësishme të funksioneve ekzistuese.

Siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave

Identitek sha kërkon që kompania ofertuese të garantojë konfidencialitetin e të dhënave sensitive. Sistemi duhet të jetë i sigurt dhe të garantojë që informacioni në sistem të jetë i vlefshëm, sipas hierarkisë së përdoruesit. Pra përdoruesit duhet të kenë akses vetëm në të dhënat që do tu jepen të drejta, sipas rolit që do ti percaktohet në sistem.

Sistemi kompjuterik i propozuar duhet të ruaje të gjitha veprimet e ruajtjes të bëra në të, me qëllim auditimin e sistemit. Për më tepër, me qëllim analizimin e këtyre të dhënave, sistemi duhet të jetë i pajisur me raporte përkatëse të organizuar për çdo përdorues, modul, etj.

Për çdo rast, të dhënat gjurmuese duhet të jenë të vlefshme për çdo veprim ruajtje që kryhet në sistem, për çdo përdorues.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 9001:2015 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 27001:2022 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.3 Kapaciteti teknik:

-
1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon një stafit të kualifikuar me të paktën 3 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), për realizimin e këtij shërbimi, me profile si më poshtë:
 - 1 (një) punonjës Specialist software
 - 1 (një) punonjës me profil Programues për migrim të dhënash / integrim
 - 1 (një) punonjës i certifikuar që kryen trajnim për programin e ofertuar

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomën përkatëse
 - Kontratën e punës e vlefshme ose kontratë bashkëpunimi
 - CV përkatëse
